



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

R.nr. 649/2024

Në lidhje me detyrimet e organeve shtetërore për të vepruar në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin në fuqi për ofrimin e kujdesit shëndetësor stomatologjik

Drejtuar: Z. Arben Vitia, Ministër
Ministria e Shëndetësisë
Z. Labinot Zeqiri, Zëvendësues i Kryeinspektorit Shëndetësor
Inspektorati Shëndetësor i Republikës së Kosovës
Z. Kastriot Meqa, Drejtor
Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës

Kopje: Z. Elvir Azizi, Drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Z. Habit Hajredini, Drejtor
Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 13 janar 2025

Qëllimi i raportit

1. Qëllim i këtij Raporti është identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut nga ana e Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK), lidhur me ankesën e [REDAKTUAR] e përfaqësuar nga [REDAKTUAR], lidhur me mosofrimin e trajtimit shëndetësor stomatologjik sipas nevojave të veçanta që i ka.
2. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e QKSUK-së në lidhje me detyrimet që i ka si organ shtetërore që gjatë trajtimit shëndetësor stomatologjik të veprojnë në përputhje me parimet e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, përfshirë standardet e aplikueshme shëndetësore stomatologjike.
3. Gjithashtu Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Shëndetësisë për nevojën e nxjerrjes së një qarkoreje, me të cilën do të kërkohej nga QKSUK-ja që në rastet e trajtimit stomatologjik të personave me nevoja të veçanta, procedura mjekësore për diagnostikim dhe trajtim mjekësor stomatologjikë t'u përshtatet veçorive të tyre.

Baza kushtetuese dhe ligjore

4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135, paragrafi 3, përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
5. Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, me dispozitat përkatëse të nenit 16 dhe të nenit 18 përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit.
6. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9 [Avokati i Popullit], paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit është Institucion i shtetit, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.”*
7. Me dërgimin e këtij raporti tek institucioni përgjegjës, Avokati i Popullit synon t'i kryejë përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të përmendura më sipër.

Sfondi ligjor përkitazi me çështjen e paraqitur në ankesë

8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), neni 7 [Vlerat], paragrafi 1, përcakton: *“Rendi Kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, të drejtës së pronës, [...]”*
9. Neni 21 i Kushtetutës përcakton: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]”*
10. Neni 22 i Kushtetutës radhit instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që: *“Zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”* Në mesin e këtyre instrumenteve

ndërkombëtare, Avokati i Popullit veçon Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (KEDNj).

11. Neni 24, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.”*
12. Neni 51 i Kushtetutës garanton mbrojtjen shëndetësore dhe sociale: *“Kujdesi shëndetësor [...] rregullohen me ligj.”*
13. Neni 53 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
14. KEDNj, neni 14 [Ndalimi i diskriminimit], përcakton: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*
15. KEDNj, Protokollin 12 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit], përcakton: *“Protokolli do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej dy muajsh pas datës në të cilën shtatë Shtete anëtare të Këshillit të Evropës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t’u lidhur me Protokollin, sipas dispozitave të nenit 8.”* Dhe: *“Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.”*
16. Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në nenin 4 [Të drejtat dhe përgjegjësitë në kujdesin shëndetësor] përcakton: *“Zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, që garantohen me Kushtetutë, dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës; të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor [...]”*
17. Ndërsa neni 5 i këtij ligji [Parimet e kujdesit shëndetësor] përcakton: *“Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u udhëhequr nga parimet themelore, si vijon: Barazia, sigurimi i qasjes së plotë ndaj shërbimeve në Listën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, pas përcaktimit të saj; për të gjithë qytetarët dhe banorët, përfshirë qasjen e lehtë deri te institucionet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar [...], gjithë-përfshirja dhe jo diskriminimi: standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përmbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurim i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës [...]”*
18. Ligji nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në nenin 1 [Qëllimi] të tij përcakton: *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe*

luftimin e diskriminimit në bazë të [...] të gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, [...]Jose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”

19. Ndërsa neni 4 i tij përcakton llojet e trajtimit të pabarabartë, ndërsa në paragrafin 2 përcakton: “Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë të bazave të përmendura në nenin 1 të këtij ligji konsiderohet diskriminim.”

Rrethanat e rastit

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i ka Avokati i Popullit, e të cilat ia ka ofruar ankuesja dhe të mbledhura nga hetimi i bërë, përmbledhen si në vijim:

20. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 21 shkurt 2024 ka pranuar ankesën e [REDAKTUAR] të cilën e përfaqëson [REDAKTUAR] (në tekstin e mëtejshëm: ankuesi), parashtruar kundër Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës (QKSUK), për shkak të diskriminimit që i është bërë në bazë të aftësisë së kufizuar duke mos i dhënë trajtim shëndetësor stomatologjik sipas veçorive që ajo i ka.
21. Sipas pohimeve të ankuesit, kuptohet se vajza e tij është person me aftësi të kufizuar [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] që nga lindja. Gjithashtu ai ka pohuar se vajza është trajtuar me hospitalizime të shpeshta për shkak të problemit me veshkat, ndërsa në dhjetor të vitit 2023 është diagnostikuar edhe [REDAKTUAR].
22. Përveç kësaj, ankuesi ka njoftuar se vajza e tij ndër vite (2014, 2018, 2020, 2022) ballafaqohej edhe me problemet shëndetësore me dhëmbët. Ajo ishte trajtuar në një spital privat, nën anestezion të përgjithshëm, sipas rekomandimit të neuropsikiatrit që e përcjell gjendjen e saj, duke marrë parasysh se ajo nuk ishte në gjendje të bashkëpunonte gjatë trajtimit stomatologjik, për shkak të veçorive të saj shëndetësore.
23. Më tutje ankuesi ka njoftuar se më 26 dhjetor 2023 kishte kërkuar për vajzën trajtim stomatologjik me anestezion të përgjithshëm në QKSUK, por një shërbim i tillë nuk i ishte ofruar dhe se vajza nuk ishte trajtuar aty, por ishte referuar në Klinikën Maksillofaciale (KMF) në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për nxjerrje të të dy dhëmbëve.
24. Sipas ankuesit, kuptohej se trajtimi stomatologjik me anestezion të përgjithshëm nuk ofrohet në Kosovë as klinikat publike dhe as në ato private, për shkak se atij i ishte thënë se një gjë e tillë nuk lejohet sipas Udhërrëfyesit Klinik për Përdorim të Azot Oksidulit (N2O/O2) si sedacion inhalator në praktikën Stomatologjike Nr. 28, i vitit 2023. Deri në nxjerrjen e këtij Udhërrëfyesi Klinik, ankuesi ka njoftuar se vajza e tij kishte marrë shërbime stomatologjike me anestezion të përgjithshëm në një spital privat në Kosovë.
25. Më 19 prill 2024, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë drejtorit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), me ç’ rast e ka njoftuar atë me pretendimet e ankuesit dhe ka kërkuar informacione lidhur me çështjen.

26. Më 2 maj 2024, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga drejtori i ShSKUK-së, përmes së cilës, ndër të tjerash, është njoftuar se QKSUK-ja ofron kujdes shëndetësor pa diskriminim për të gjithë qytetarët, duke u bazuar në nenin 5 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, e në veçanti për pacientët me aftësi të kufizuara dhe me sëmundje specifike. Më tutje në njoftim thuhej se në QKSUK nuk ofrohen trajtime mjekësore dentare me anestezion të përgjithshëm për pacientët e vet, ndërsa për sa u përket pacientëve të cilët kanë nevojë të trajtohen me anestezion të përgjithshëm, ata udhëzohen në Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale, në të cilën kryhen vetëm nxjerrjet e dhëmbëve nën anestezion të përgjithshëm, ndërsa në QKSUK ofrohet trajtim mjekësor dentar vetëm me anestezion lokal. Rasti në fjalë është udhëzuar në Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale, për shkak se pacientja ka pasur indikacion nxjerrjen e dhëmbëve, i cili shërbim ka qenë i pamundur të realizohej me anestezion lokal. Metoda e aplikimit të sedacionit inhalator që në QKSUK ka filluar në dhjetor 2023, nuk ofron mundësinë e anestezionit total.
27. Më 3 shtator 2024, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit ka kontaktuar me ankuesin, nga i cili ka kërkuar informata për gjendjen shëndetësore stomatologjike të vajzës. Ai ka njoftuar se vajza ka marrë trajtim stomatologjik me anestezion të përgjithshëm në një spital privat në Shqipëri. Për më tepër, ai ka njoftuar se për rreth 10 orë vajza ka qenë me anestezion të përgjithshëm, ku ka pasur intervenime të ndryshme (nxjerrje, riparime) në 17 dhëmbë, dhe tani gjendja e saj është e mirë. Ankuesi konsideron se me mosofrimin e trajtimit stomatologjik me anestezion të përgjithshëm për vajzën, QKSUK-ja ka kryer diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore, rrjedhimisht vajzës i është cenuar e drejta për trajtim shëndetësor.

Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

28. Duke marrë parasysh që Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNJ-së, Avokati i Popullit sjell parasysh disa vendime të kësaj gjykate, të përfshira në Udhëzuesin për nenin 14 të Konventës (Ndalimi i diskriminimit) dhe për nenin 1 të Protokollit nr. 12 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit).¹
29. GjEDNJ-ja ka konfirmuar se objekti i nenit 14 të Konventës dhe i nenit 1 të Protokollit Nr. 12 përfshin diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar, të gjendjes shëndetësore ose të veçorive gjenetike (*Glor kundër Zvicrës, 2009, § 80; G.N. dhe të tjerët kundër Italisë, 2009, § 126; Kiyutin kundër Rusisë, 2011, § 57*). Në rastet në lidhje me aftësinë e kufizuar, kufiri i vlerësimit të shteteve në vendosjen e trajtimit të ndryshëm ligjor për personat me aftësi të kufizuara është reduktuar ndjeshëm (*Glor kundër Zvicrës, 2009, § 84*). Kjo do të thotë se, megjithëse GjEDNJ-ja për çështje të caktuara u lë shteteve hapësirë të gjerë për kufirin vlerësimit, këtë hapësirë e ngushton ndjeshëm kur bëhet fjalë për personat me aftësi të kufizuar.

¹ Guide on Article 14 of the Convention (prohibition of discrimination) and on Article 1 of Protocol No. 12 (general prohibition of discrimination)- Prohibition of discrimination, European Court of Human Rights

30. Duke iu referuar veçanërisht Rekomandimit 1592 (2003) drejt përfshirjes së plotë sociale të njerëzve me aftësi të kufizuara, miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, më 29 janar 2003, dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD), miratuar më 13 dhjetor 2006, GjEDNJ-ja ka konsideruar se ka një konsensus evropian dhe mbarëbotëror mbi nevojën për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara nga trajtimi diskriminues (*Glor kundër Zvicrës, 2009, § 54*). Kjo përfshin një detyrim për shtetet për të siguruar “akomodim të arsyeshëm” për t’ua lejuar personave me aftësi të kufizuara mundësinë për t’i realizuar plotësisht të drejtat e tyre dhe dështimi për ta bërë këtë përbën diskriminim (*Enver Şahin kundër Turqisë, 2018, §§ 67-69; Çam kundër Turqisë, 2016, §§ 65-67; G.L. kundër Italisë, 2020, §§ 60-66*).

Analiza juridike, vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

31. Avokati i Popullit, gjatë zhvillimit të hetimeve dhe analizës së përgjigjes së QKSUK-së, vëren se vajza e ankuesit është person me aftësi të kufizuara dhe se ndër vite ka marrë shërbime stomatologjike me anestezion të përgjithshëm nga një spital privat në Kosovë, për shkak të pamundësisë për të bashkëpunuar si pasojë e veçorive të saj shëndetësore dhe sipas rekomandimit të neuropsikiatrit që e përcjell gjendjen e saj në vazhdimësi.
32. Gjithashtu vërehet se më 26 dhjetor 2023, vajza e ankuesit ka qenë në QKSUK për të marrë shërbime stomatologjike, por për shkak të pamundësisë për të bashkëpunuar si pasojë e veçorive të saj shëndetësore, ajo është udhëzuar nga stomatologu i QKSUK-së - Klinika e Pedodoncisë - për në KMF për nxjerrje të të dy dhëmbëve.
33. Për Avokatin e Popullit mbetet shqetësues veprimi i stomatologut të QKSUK-së, i cili pa ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të trajtimit të vajzës së ankuesit, bazuar në specifikat e gjendjes së saj shëndetësore, pa e realizuar fare ekzaminimin e dhëmbëve të saj, e ka vlerësuar se dhëmbët duhet të nxirren dhe e ka udhëzuar atë për nxjerrje të dhëmbëve në KMF me anestezion të përgjithshëm.
34. Avokati i Popullit thekson se vajza nuk është ekzaminuar fare dhe është udhëzuar vetëm për nxjerrje të dhëmbëve, pa e vlerësuar nëse dhëmbët duhet të nxirreshin apo të shëroheshin, procedurë kjo që normalisht zbatohet për persona të tjerë që nuk i kanë veçoritë shëndetësore sikurse të vajzës së ankuesit. Praktikisht vajzës së ankuesit i është ofruar vetëm shërbimi i nxjerrjes së dhëmbëve, me anestezion të përgjithshëm, por jo edhe shërimi i dhëmbëve, të cilin ajo më vonë e kishte realizuar në Shqipëri.
35. Nga përgjigjja e drejtorit të QKSUK-së është kuptuar se në QKSUK nuk ofrohen trajtime mjekësore dentare me anestezion të përgjithshëm, por vetëm me anestezion lokal, por në rastet kur pacientët kanë nevojë të trajtohen me anestezion të përgjithshëm, ata udhëzohen në KMF në të cilën kryhet vetëm nxjerrja e dhëmbëve me anestezion të përgjithshëm, sikurse rasti i ankuseses që ka pasur indikacione për nxjerrje të dhëmbëve.
36. Çfarë veçanërisht bie në sy është se në Kosovë, personat me specifika të veçanta shëndetësore,

që kanë nevojë t'i rregullojnë dhëmbët me anestezion të përgjithshëm në QKSUK, nuk e marrin këtë trajtim, por ata vetëm referohen në KMF për nxjerrje me anestezion të përgjithshëm, sikurse që është rasti i vajzës. Sipas pohimeve të ankuesit, as në institucionet shëndetësore private nuk mund ta marrin këtë shërbim, ngase i është thënë se Udhërrëfyesi Klinik për Përdorim të Azot Oksidulit (N₂O/O₂) si sedacion inhalator në praktikën Stomatologjike Nr. 28 nuk e lejon përdorimin e anestezionit të përgjithshëm.

37. Referuar Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, përkatësisht nenit 4, ku përcaktohen të drejtat dhe përgjegjësitë në kujdesin shëndetësor, kuptohet se zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, që garantohen me Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, si dhe të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë për qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor. Neni 13 i po këtij ligji ka përcaktuar se praktikatat më të mira të kujdesit shëndetësor përcaktohen në formë të udhëzuesve të praktikës klinike, standardeve, protokolleve [...].
38. Avokati i Popullit vlerëson se në bazë të këtyre përcaktimeve ligjore dhe në frymën e standardeve ndërkombëtare, më 2023 Ministria e Shëndetësisë, si standard klinik e kishte publikuar Udhërrëfyesin Klinik Nr. 28. Kuptohet se qëllimi i këtij Udhërrëfyesi Klinik është ofrimi i rekomandimeve për përdorimin e sedatimit inhalator për stomatologët në të gjitha nivelet e shërbimeve në stomatologji.
39. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se përdorimi N₂O/O₂² në stomatologji, i përcaktuar me Udhërrëfyesin Klinik si trajtim terapeutik, e lehtëson dhe shpejton punën e stomatologut me pacientë, përfshirë këtu edhe shumë grupe të pacientëve me nevoja të veçanta. Udhërrëfyesi Klinik ka përcaktuar edhe qëllimet e përdorimit të tij, ku rëndësia e secilit nga qëllimet ndryshon varësisht nga natyra e procedurës stomatologjike dhe karakteristikat e pacientit. Në Udhërrëfyesin Klinik thuhet: "*N₂O/O₂ inhalimi sygjerohet si alternativë për anestezion të përgjithshëm në menaxhim të pacientëve me nevoja të veçanta mjekësore.*"³ Në rastin konkret, stomatologu së paku nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të shikuar mundësitë e veprimit sipas këtij Udhërrëfyesi Klinik.
40. Duke u nisur nga ky përcaktim, Avokati i Popullit vëren se Udhërrëfyesi Klinik nuk e ka ndaluar anestezionin e përgjithshëm inhalator me N₂O/O₂, por ka përcaktuar kufizimet në përdorimin e tij, si dhe nivelet e sedacionit, ku parashihet edhe anestezioni i thellë dhe i përgjithshëm.⁴
41. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konstaton se vajza, si person me aftësi të kufizuara, nuk ka arritur të marrë trajtim të nevojshëm mjekësor stomatologjik në QKSUK dhe në këtë rast asaj i është i shkelur e drejta për kujdes dhe mbrojtje shëndetësore të barabartë, e garantuar me

² <https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Udh%C3%ABr49089899.7954.pdf>, faqe 17.

³ Po aty, faqe 23, paragrafi i parafundit.

⁴ Po aty, faqe 12 dhe 15.

nenin 51 i Kushtetutës së Kosovës.

42. Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se mostrajtimi shëndetësor stomatologjik nga QKSUK-ja i pacientes sipas karakteristikave të veçanta që ajo i ka, shpie në diskriminim mbi bazën e gjendjes shëndetësore të saj dhe diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar ndaj saj, sipas disa nga bazat e mbrojtura me nenin 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ky trajtim i pabarabartë në raport me karakteristikat e mbrojtura e ka diskriminuar atë duke ia kufizuar të drejtën themelore të vajzës për kujdes shëndetësor të barabartë, që garantohet me nenin 51 të Kushtetutës dhe me nenin 14 dhe me nenin 1 të Protokollin 12 të KEDNJ-së.
43. Avokati i Popullit rikujton që sipas GJEDNJ-ja, në rastin *Thlimmenos kundër Greqisë* (2000), se e drejta për tu mos diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara sipas Konventës shkelet kur shtetet trajtojnë ndryshe personat në situata analoge pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. (§ 44). Megjithatë, Gjykata vlerëson se kjo nuk është aspekti i vetëm i ndalimit të diskriminimit në nenin 14. E drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të garantuara sipas Konventës cenohet gjithashtu kur shtetet pa një justifikim të arsyeshëm nuk trajton ndryshe personat, situatat e të cilëve janë dukshëm të ndryshme.” (§ 44)
44. Gjithashtu, Avokati i Popullit konstaton se rasti i vajzës së ankuesit shpërfaq dukurinë që potencialisht në një situatë të tillë mund të gjenden edhe personat e tjerë me aftësi të kufizuar apo persona me veçori shëndetësore, kur ata kërkojnë shërbime stomatologjike, që për shkak të pamundësisë së ekzaminimit (mosbashkëpunim i tyre me stomatologun) dhe trajtimit me anestezion të përgjithshëm, pa një vlerësim paraprak, ata referohen vetëm për nxjerrje me anestezion të përgjithshëm në një klinikë tjetër.
45. Avokati i Popullit konstaton se personeli shëndetësor në QKSUK nuk e ka mjaftueshëm të qartë trajtimin e personave me aftësi të kufizuar dhe të personave me veçori specifike shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore stomatologjike sipas Udhërrëfyesit Klinik nr. 28, që për pasojë ka moszbatimin e vetë këtij Udhërrëfyesi.

Prandaj, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministritë së Shëndetësisë:

1. Nëpërmjet një qarkoreje të veçantë, të kërkojë nga të gjitha institucionet shëndetësore publike, që ofrojnë trajtime shëndetësore stomatologjike, që në rastet e trajtimit stomatologjik të personave me aftësi të kufizuar dhe të personave me veçori specifike shëndetësore, procedura mjekësore për diagnostikim dhe trajtim mjekësor stomatologjikë t'u përshtatet nevojave të tyre.
2. Të krijohen protokolle për kompensimin e shpenzimeve të qytetarëve për shërbimet stomatologjike të cilat nuk ofrohen në vend, por që ka mundësi të kryhen jashtë vendit.


Inspektoratit Shëndetësor:

3. Në pajtim me Ligjin nr. 08/L-049 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor, të monitorohet zbatimi i normave dhe të standardeve të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë nga institucionet shëndetësore.

Qendrës Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës:

4. Në rastet e diagnostikim dhe trajtim mjekësor stomatologjik të personave me aftësi të kufizuar dhe të personave me veçori specifike shëndetësore të zbatohet Udhërrëfyesi Klinik për Përdorim të Azot Oksidulit (N₂O/O₂) si sedacion inhalator në praktikën Stomatologjike Nr. 28.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit